



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË KONCESIONEVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____._____.2024

Lënda: Dërgohet raporti 12-mujor për vitin 2024 mbi monitorimin e buxhetit të Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve, ATRAKO.

MINISTRISË SË EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORISË SË BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

1. Hyrje, përshkrimi i institucionit

Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO) është një institucion buxhetor, në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit që ka si mision të nxisë dhe asistojë Autoritetin/et Kontraktor në përgatitjen, vlerësimin dhe negocimin e koncesioneve/partneriteteve publike private.

Agjencia, ushtron funksionet e Njesisë së Trajtimit të Koncesioneve/Partneriteteve Publike Private, të ngarkuara sipas ligjit nr.125/2013 “Për koncesionet/PPP”, i ndryshuar,

Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve asiston autoritetet kontraktore me qëllim:

- a) Përgatitjen e studimit të fizibilitetit;
- b) Përgatitjen e dokumenteve të procedurës konkurruese dhe kriterëve të vlerësimit;
- c) Vlerësimin e propozimeve dhe përcaktimin e ofertuesit më të mirë;
- d) Kryerjen e negociimeve dhe nënshkrimin e kontratës së koncesionit

ATRAKO, deri në përfundim të vitit ushtrimor 2023, ka qenë pjesë e planit buxhetor të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Grupi 10. Në fillim të vitit 2024, me hyrjen në fuqi të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.30, datë 17.01.2024, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit" dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 17.01.2024 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë të Ministrisë së Financave", institucioni ynë u klasifikua si pjesë e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, grupi

12.

Në vijim, me shkresën e Ministrisë së Financave me nr. 2917/1 prot., datë 12.03.2024, na u komunikua dhe ndryshimi i kodeve të institucionit, duke u shoqëruar me një proces gati 1 (një) mujor të transferimit të fondeve nga kodi i institucionit si pjesë e Grupit 10 (MF), në kodin e ri të institucionit si pjesë e Grupit 12 (MEKI).

Duke qenë se në zbatim të Udhëzimit nr.14, datë 30.05.2023, të sipërcituar, raportimi i monitorimit të buxhetit bëhet 4 -mujor, sqarojmë se shpenzimet buxhetore të kryera nga ana jonë për këtë periudhë raportuese janë të ndara në dy grupe buxhetore, konkretisht për periudhën Janar – Mars 2024, fondet janë akorduar dhe shfrytëzuar si pjesë e Grupit 10 (MFE), ndërsa për periudhën Prill-Dhjetor 2024, fondet e papërdorura brenda limitit vjetor të miratuar me ligjin nr. 97/2023, janë mbartur në Grupin 12 (MEKI).

ATRAKO bën pjesë në programin buxhetor “ Mbështetje për zhvillimin ekonomik, me kodin 04130 dhe programi ka për qëllim ti shërbejë :

- krijimit të një klime pozitive për zhvillimin e biznesit, për krijimin e vendeve të reja të punës, reduktimit të informalitetit në ekonomi,
- krijimit të një mjedisi konkurrues për zhvillimin e investimeve,
- krijimit të kushteve të barabarta për konkurrence si dhe një treg të sigurtë për konsumatorin;
- përmirësimin e cilësisë së menaxhimit dhe performances ekonomike të shoqërive tregtare ,
- krijimit të një sistemi që garanton realizimin e detyrimeve kontraktore ndërmjet bizneseve.

Objektivat e politikës së programit për ATRAKO-n:

- Studime Fizibiliteti për Projekte Koncesione/PPP nëpërmjet pjesëmarrjes në Komisionin e Dhënies të Koncesionit/PPP duke dhënë asistencë në studimin e fizibilitetit, hartimin e dokumentave standarte të tenderit, vlerësimin e ofertave të projekteve, negocimin e kontratës.
- Kontrata Koncesioni/PPP të publikuara në Regjistrin Elektronik të Koncesioneve Autoritetet Kontraktore përcjellin pranë ATRAKO-s për publikim kontratat e Koncesionit/PPP, 15 ditë pas nënshkrimit të tyre.

2. Informacion buxhetor

Në bazë të ligjit të Buxhetit Nr. 97/2022 “Për buxhetin e vitit 2024”i ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.08.2008 “Për sistemin e menaxhimit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të udhëzimit nr.14, datë 30.05.2023 “Për Procedurat Standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore, ATRAKO, gjatë periudhës raportuese **Janar – Dhjetor 2024**, ka administruar dhe menaxhuar fondet e vëna në dispozicion nga Buxheti i Shtetit .

Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2024 janë shpenzuar fondet buxhetore si më poshtë:

a. Shpenzimet Operative për periudhen Janar – Dhjetor 2024 (Tabela Nr.1)

ART	PLAN VJETOR	Buxheti I Rishikuar 2024 (A)	Shpenzime Faktike 12 mujori 2024 (B)	Gjendje ne 31.12.24	Shpenzime ne % (B/A)	Gjendj e ne %
600	19,502,670	15,500,000	15,316,468	183,532	99%	1%
601	3,494,324	3,600,000	2,333,410	1,266,590	65%	35%
600999						
602	2,634,281	2,652,000	1,382,352	1,269,648	52%	48%
602	1,300,000	1,300,000	0	1,300,000	0%	100%
606	124,000	128,000	56,616	71,384	44%	56%
602999						
230999						
Totali	27,055,275	23,180,000	19,088,846	4,091,154		

- Buxheti i shtetit për vitin 2024 akordoi për ATRAKO-n vlerën prej **23,180,000** lekë (tabela nr.1) Shpenzimet buxhetore për 12 mujorin e vitit 2024 janë në shumën **19,088,846** lekë.
- Struktura aktuale e Agjencisë e miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 123 datë 16.10.2012 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve” ka në organikë 12 (dymbëdhjetë) punonjës. deri në muajin qershor 2024 numri faktik i punonjësve ishte 7 punonjës, Vakancat që kanë qenë në 6 -mujorin e parë të 2024 jan plotësuar në muajin Korrik 2024 dhe tani funksionojmë sipas strukturës së plotë.
- Në zbatim të udhëzimit plotësues nr, 9 datë 10.07.2024 për përgatitjen e “Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027” të politikës dhe objektivave të programit ekonomik “Mbështetje për zhvillimin Ekonomik” si dhe tavanëve të miratuara me vendimin e këshillit të ministrave me nr. 535 datë 12.08.2024 për fazën II, atë teknike të PBA 2025-2027, ju bëjmë me dije se taveri i ri që është miratuar për 2025 për ATRAKO është 33,161,000 lekë.
- Referuar shkresës Nr. 10783/2 datë 03.09.2024.2023 me lëndë: “Dërgohet shkresa Nr. 11402/4 Prot datë 02/09/2024 “Mbi detajimin e ndryshimeve të buxhetit” sipas aktit normativ nr 3. datë 28/8/24, po ju paraqesim më poshtë detajimet për tavanet dhe kërkesat tona për vitin 2025:

Nr	Llogaria kontable	Tavani
1	600	25,161,000
2	601	4,000,000
3	602	3,952,000
5	606	48,000
Total		<u>33,161,000</u>

3. Performance me bazë gjinore, në nivel produkti

ATRAKO, ka objekt veprimtarie asistencën pranë Autoriteve Kontraktore dhe nuk ka target grupe me bazë gjinore dhe as nuk bën trajtime me bazë gjinore, ndaj është e vështirë të bëj analizë të treguesve gjinorë.

4. Performanca e Buxhetit

Për periudhën raportuese Janar – Dhjetor 2024, ATRAKO ka pasur vijimësi dhe ecuri të realizimit të shpenzimeve korrente, në nivelin 59 % të fondeve totale të akorduara për vitin 2024.

Detajim i llogarive ekonomike sipas zërave të buxhetit:

- **Shpenzime për paga**(artikulli 600) është realizuar në masën 99% të fondit të rishikuar të buxhetit për vitin 2024.
- **Shpenzime për sigurime shoqërore, shëndetsore** (artikulli 601) është realizuar në masën 65% të fondit të rishikuar të buxhetit për vitin 2024.
- **Shpenzime për mallra, shërbime** (artikulli 602) është realizuar në masën 52% të fondit të rishikuar për vitin 2024.
- **Transfertat për buxhetet familjare dhe individ** (artikulli 606) është realizuar në masën 44% të fondit të rishikuar të buxhetit për vitin 2024.
- Për vitin 2024 nuk ka të akorduara fonde për shpenzime kapitale.

Në lidhje me procedurat e prokurimit për vitin 2024, procedura “Mirëmbajtje Regjistri elektronik të koncesioneve/PPP”, e cila do të zinte një pjesë të konsiderueshme të fondit për mallra, shërbime, nuk është realizuar pasi nuk kemi marrë përgjigje nga AKSHI apo dhe nga institucione të tjera për të vazhduar apo jo me kryerjen e kësaj procedure.

Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël u realizuan gjatë 3 mujeve të fundit të 2024.

Në zbatim të Udhëzimit nr. 36 dt. 17.12.2019 “Për përgjegjësitë e përdoruesve në SIMF” prej muajit Shtator 2022 nëpërmjet logimit në AFMIS “**Albanian Financial Management Information System**”, Portali për dokumentacion në Thesar janë kryer online të gjitha pagesat në buxhetin e shtetit.

Të ardhurat

Në zbatim të VKM nr. 285 datë 10.04.2020 “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e nivelit të tarifave të shërbimeve që do të ofrohen nga ATRAKO”, Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve përfiton të ardhura nga shërbimet e asistencës së kryera pranë Autoriteteve Kontraktore, për procedurat e dhënies me koncesion/PPP të projekteve nëse këto procedura rezultojnë të suksesshme.

Shuma që paguhet për shërbimet e Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO), shpallet në dokumentet e garës dhe paguhet nga koncesionari fitues, si më poshtë vijon:

Vlera e projektit/leke	Tarifa/LEKE
Për projektet koncesionare deri ne 700,000,000 leke	700, 000 leke
Për projektet koncesionare mbi 700,000,000 leke deri ne 2,100,000,000 leke	1,400,000 leke
Për projektet koncesionare mbi 2,100,000,000 leke deri ne 7,000,000,000 leke	2,800,000 leke
Për projektet koncesionare mbi 7,000,000,000 leke	4,200,000 leke

4.1 Performanca jo-financiare

Në përputhje me misionin e saj, me qëllim rritjen e transparencës, respektimin e procedurave për dhënien me koncesion/PPP nga të gjithë Autoritetet Kontraktore dhe standardizimin e tyre. Në 12-mujorin e vitit 2024 :

- Agjencia është marrë me asistimin në hartimin e studimit të fizibilitetit për **3 projekte** koncesionare PPP.
Është duke Asistuar autoritetet kontraktuese, me qëllim:
- përcaktimin e procedurës së zbatueshme për dhënien e koncesionit/partneritetit publik privat dhe hartimin e dokumenteve të procedurës konkurruese dhe kritereve të vlerësimit, për 2 projekte.
- shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të pranura dhe/ose kërkesat për pjesëmarrje, AK nuk kanë dorëzuar për asnjë projekt;

- d. kryerjen e negocimeve të kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat për **3 (tre) projekte**;
- e. Me qëllim rritjen e transparencës mbi kontratat e koncesionit/PPP, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 211 datë 16.03.2016 “Për krijimin dhe administrimin e regjistrit elektronik të koncesioneve/PPP” sipas informacionit të përcjellë nga Autoritetet Kontraktore, Agjencia ka publikuar 1 kontratë dhe 2 anekse/shtesa kontratash.

Propozime për përmirësimin e situatës, me qëllim arritjen dhe përmbushjen e objektivave :

- **Standardizimi i procedurave për monitorimin e kontratave të Koncesionit/PPP-ve**
- **Ristrukturimi i Agjencisë nëse do të ketë ndryshime ligjore në ligjin e koncesioneve /PPP-ve.**
- **Funksionimi në mënyrë efikase të regjistrit të Koncesioneve/PPP-ve.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

KRYETAR

Emiliano Gjika